



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 26, Datë 27.01.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“5GX ENERGY” SH.P.K. PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR
TRANSFERIMIN (NËPËRMJET VENDOSJES SË BARRËS SIGURUESE) TË
ASETEVE FIKSE TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, gërmat “a” dhe “b”, nenit 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 99, datë 17.06.2026; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.01.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 35/1 prot., datë 24.01.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve të paluajtshme të saj”,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 35 prot., datë 08.01.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve fikse të krijuara apo që do të krijohen të shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k., si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “TIRANA BANK” sh.a.
- Shoqëria 5GX ENERGY sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik në Zonën Kadastrale 1020, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje, Qarku Fier me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 135, datë 09.07.2024.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, rezulton se shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k., ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g”, “i”, “j”; pikën 3; pikën 4 dhe pikën 6.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:

Neni 7, Pika 1

- **gërma “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve.
- **gërma “h”:** Shoqëria duhet të depozitojë listën e plotë të asetëve fikse që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, e cila duhet të jetë pjesë e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet palëve.

Referuar nenit 5, gërmat “h” dhe “j” të “Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve nga të licensuarit”, ERE shprehet vetëm për asetet ekzistuese, që përbëjnë aktive afatgjata materiale dhe shërbejnë drejtpërdrejt aktivitetit të licencuar. ERE nuk shprehet për asetet e pakrijuara, të pamaterializuara si investime konkrete ose të papasqyruara si aktive. Për rrjedhojë, çdo kërkesë për transferim duhet të shoqërohet me një listë të detajuar të asetëve fikse ekzistuese, që janë pjesë integrale e aktivitetit të licencuar dhe përmbushin kriteret e Rregullores.

Po ashtu, vlerësohet të sqarohet me shoqërinë dhe/ose bankën se si është vijuar me nënshkrimin e kontratës përfundimtare për barrësimin e asetëve pa marrë më parë autorizimin e ERE-s në lidhje me këtë barrësim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës sigurorese) e asetëve fikse të shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimeve ndaj “TIRANA BANK” sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “5GX ENERGY” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI